

DAIKIN

SERIA SPLIT R32

MANUALI I PËRDORIMIT

Siesta®

INVERTER



Shijoni komoditetin gjatë gjithë vitit.

MODELET

ATXTP25K3V1B

ATXTP35K3V1B

Rritje e komfortit dhe e kursimeve të energjisë



QARKULLIM AJRI KOMFORT

Drejtimi i fryrjes së ajrit është i drejtuar lart gjatë regjimit FTOHJE, dhe i drejtuar poshtë gjatë regjimit NGROHJE. Ky funksion parandalon fryrjen direkt mbi trupin tuaj të ajrit të ftohtë ose të ngrohtë. ► [Faqe 13](#)



EKONOMIK

Ky funksion mundëson funksionimin efikas duke kufizuar konsumin maksimal të energjisë. Është i dobishëm kur njësia përdoret njëkohësisht me pajisje të tjera elektrike në të njëjtin rrjet elektrik. ► [Faqe 14](#)



Përmbajtja

■ Leximi përpara përdorimit

Masat e sigurisë	3
Emrat e pjesëve	5
Përgatitja përpara përdorimit	8

■ Përdorimi bazë

 Përdorimi i AUTO · FTOHJE · THARJE · NGROHJE · VETËM VENTILATOR	9
 Përshtatja e shpejtësisë së fryrjes së ajrit	11
 Përshtatja e drejtimit të fryrjes së ajrit	12

■ Funksionet e dobishme

 Përdorimi i funksionit QARKULLIM AJRI KOMFORT	13
 Përdorimi i funksionit I FUQISHËM ...	13
 Përdorimi i funksionit EKONOMIK	14

■ Përdorimi i KOHËMATËSIT

 Përdorimi i KOHËMATËSIT TË NDEZJES/FIKJES	15
---	----

■ Kujdesi

Kujdesi dhe pastrimi	17
----------------------------	----

■ Kur lind nevoja

FAQ	21
Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve	22

Anglishtja është gjuha e tekstit të udhëzimeve origjinale.
Gjuhët e tjera janë përkthime të udhëzimeve origjinale.

Masat e sigurisë



Lexoni me kujdes masat në këtë manual përpara përdorimit të njësishë.



Kjo pajisje është e mbushur me gaz ftohës R32.

- Mbajeni këtë manual në një vend ku përdoruesi mund ta gjejë lehtë.
- Lexoni me kujdes masat në këtë manual përpara përdorimit të njësishë.
- Kjo pajisje është menduar të përdoret nga përdorues ekspertë ose të trajnuar, në oficinë, industrinë e lehtë ose në ferma, ose për përdorim në ambiente tregtare ose familjare nga persona të zakonshëm.
- Niveli i presionit të tingullit është më i vogël se 70 dB (A).
- Masat e përshkruara këtu klasifikohen si PARALAJMËRIM dhe KUJDES. Që të dyja këto përmbajnë informacion të rëndësishëm për sigurinë. Sigurohuni që t'i zbatoni të gjitha masat pa përjashtim.



PARALAJMËRIM

Mosveprimi në përputhje me këto udhëzime mund të rezultojë në lëndim personi ose në humbje të jetës.



KUJDES

Moszbatimi i këtyre udhëzimeve në mënyrën e duhur mund të rezultojë në dëme materiale ose lëndim personi, të cilat mund të jenë serioze në varësi nga rrethanat.



Mos provoni kurrë.



Sigurohuni të ndiqni udhëzimet.



Sigurohuni të realizoni një lidhje tokëzimi.

- Pas leximit, mbajeni manualin në një vend të përshatshëm që t'i referoheni sa herë ta keni të nevojshme. Nëse pajisja i kalohet një përdoruesi të ri, sigurohuni që t'i jepni atij edhe këtë manual përdorimi.



PARALAJMËRIM



- Pajisja duhet të vendoset në një dhomë ku nuk ka përdori të vazhdueshëm të burimeve të ndezjes (p.sh. flakë të hapura, pajisje që punon me gaz apo ngrohëse elektrike funksionale).
- Për të shmangur zjarrin, shpërthimin ose lëndimin, mos e përdorni njësien kur pranë saj është konstatuar prani e gazeve të dëmshëm (p.sh. të ndezshëm ose gërryes).
- Jini të vetëdijshëm që ekspozimi i drejtpërdrejtë dhe për një kohë të gjatë në ajrin e ftohtë ose të ngrohtë të njësishë mund të jetë i dëmshëm për gjendjen fizike dhe për shëndetin tuaj.
- Mos futni objekte, duke përfshirë shkopinjat, gishtërinjtë tuaj etj. në vrimën e futjes ose të daljes së ajrit. Dëmtimi i produktit ose lëndimi i personit mund të rezultojë për shkak të kontaktit me fletët e ventilatorit me shpejtësi të lartë të njësishë.
- Mos tentoni të riparoni, çmontoni, riinstaloni apo modifikoni vetë njësien, pasi kjo mund të rezultojë në rrjedhje uji, goditje elektrike ose rrezik për zjarr.
- Mos përdorni spërkatës me lëndë të ndezshme pranë njësishë, sepse në të kundërt mund të bjerë zjarr.
- Mos përdorni gaz tjetër ftohës përveç atij që tregohet në njësien e jashtme (R32) kur kryeni instalim, zhvendosje apo riparim. Përdorimi i gazeve të tjera ftohëse mund të shkaktojë probleme ose të dëmtojë njësien, si she mund të shkaktojë lëndime të njerëzve.
- Për të shmangur goditjen elektrike, mos e përdorni me duar të lagura.
- Mos e lani me ujë njësien, sepse kjo gjë mund të shkaktojë goditje elektrike ose zjarr.
- Mos vendosni enë me ujë (vazo lulesh etj.) mbi njësi, sepse kjo mund të çojë në goditje elektrike ose rrezik për zjarr.
- Jini të kujdesshëm për rrezikun e zjarrit në rastin e rrjedhjes së gazit ftohës. Nëse njësia nuk punon si duhet, d.m.th. nuk krijon ajër të ngrohtë ose të ftohtë, shkaku mund të jetë rrjedhja e gazit ftohës. Konsultohuni me shitësin tuaj për ndihmë. Gazi ftohës brenda njësishë është i sigurt dhe zakonisht ai nuk rrjedh.
- Megjithatë, nëse rrjedh, kontakti me një flakë të zbuluar, me një rezistencë ose vatër gatimi mund të shkaktojë krijimin e gazeve helmues. Mos e përdorni njësien derisa një person i kualifikuar shërbimi të konfirmojë se është eliminuar rrjedhja e gazit.
- Mos u përpuni që ta instaloni apo ta riparoni vetë njësien. Punimi i gabuar mund të rezultojë në rrjedhje të ujit, goditje elektrike ose rrezik për zjarr. Kontakti me shitësin lokal ose persona të kualifikuar për instalimin dhe punimet e mirëmbajtjes.
- Kur njësia nuk punon si duhet (kur nxjerr një erë si të djegur etj.) shkëputni nga njësia energjinë elektrike dhe kontakti me shitësin lokal. Vazhdimi i përdorimit në këto kushte mund të shkaktojë prishjen e kondicionerit ose rrezikun e goditjes elektrike ose të zjarrit.
- Siguroni instalimin e një automati mbrojtës të rrjedhjes së tokëzimit. Nëse nuk instalohet një automat mbrojtës i rrjedhjes së tokëzimit, ekziston rreziku i goditjes elektrike ose i zjarrit.



- Siguroni tokëzimin e njësishë. Mos e tokëzoni njësien në një tubacion uji, përcjellës rrufeje ose kablo telefonie nën tokë. Tokëzimi i pasaktë mund të rezultojë në goditje elektrike.



KUJDES

- Mos e përdorni njësien për qëllime të tjera të ndryshme nga ato për të cilat është menduar. Mos e përdorni njësien për ftohjen e instrumenteve të precizionit, të ushqimit, bimëve, kafshëve ose të veprave të artit, sepse kjo mund të ndikojë negativisht në performancën, cilësinë dhe/ose jetëgjatësinë e objektit në fjalë.

Masat e sigurisë



- Mos i ekspozoni bimët ose kafshët direkt në rrymën e ajrit që del nga njësia, sepse kjo mund të shkaktojë efekte të padëshiruara.
- Mos vendosni pajisje që kanë flakë të pambluara në vendet e ekspozuara ndaj rrymës së ajrit nga njësia, sepse kjo mund të ndikojë në djegien nga vatra e zjarrit.
- Mos bllokoni hyrjet ose daljet e ajrit. Qarkullimi i dobësuar i ajrit mund të rezultojë në rendiment të pamjaftueshëm ose në probleme.
- Mos u ulni mbi njësinë e jashtme, mos vendosni objekte mbi njësi ose mos e tërhiqni atë. Veprimi në këtë mënyrë mund të shkaktojë aksidente, si p.sh. rënia ose përmbysja, duke çuar në lëndim, keqfunksionim të produktit ose dëmtim të tij.
- Mos vendosni nën njësinë e brendshme ose të jashtme objekte që prishen nga lagështia. Në disa rrethana, kondensimi në njësinë qendrore ose në tubat e gazit, papastërtitë në filtrin e ajrit ose bllokimi i vrimës së kullimit mund të shkaktojë pikimin e ujit, duke çuar në ndotjen ose prishjen e objektit në fjalë.
- Pas përdorimit për një kohë të gjatë, kontrolloni për dëmtim bazamentin e njësisë dhe mbajtëset e saj. Nëse ato lihen në gjendje të dëmtuar, njësia mund të rrëzohet dhe të shkaktojë lëndime.
- Mos prekni vendin e hyrjes së ajrit ose fletët prej alumini të njësisë së brendshme apo të jashtme, që të mos lëndoheni.
- Pajisja nuk është parashikuar të përdoret nga fëmijë të vegjël të pambikëqyrrur apo nga persona jo të sigurt. Kjo mund të çojë në dëmtim të funksioneve trupore dhe rrezik për shëndetin.
- Kjo pajisje mund të përdoret nga fëmijët e moshës 8 vjeç e lart dhe nga personat me aftësi të kufizuara fizike, ndijuese ose mendore apo nga personat që nuk kanë përvojë dhe njohuri, vetëm nëse ata mbikëqyren ose udhëzohen për përdorimin e pajisjes në mënyrë të sigurt dhe kuptojnë rreziqet që lidhen me të.
- Fëmijët nuk duhet të luajnë me pajisjen.
- Pastrimi dhe mirëmbajtja nga përdoruesi nuk duhet të kryhet nga fëmijët pa i mbikëqyrrur ata.
- Shmangni goditjet e njësisë së brendshme ose të jashtme, sepse në të kundërt mund të çojnë në dëmtim të produktit.
- Mos vendosni nën material të ndezshëm, p.sh. kaneçe për spërkatje, brenda distancës 1 m nga dalja e ajrit. Kaneçet për spërkatje mund të shpërthejnë si rezultat i ajrit të nxehtë që del nga njësia e brendshme ose e jashtme.
- Bëni kujdes të mos lejoni kafshët shtëpiake të urinojnë mbi njësi. Urinimi mbi njësi mund të rezultojë në goditje elektrike ose në zjarr.
- Mos e lani me ujë njësinë, sepse kjo gjë mund të shkaktojë goditje elektrike ose zjarr.
- Mos vendosni nën ujë (vazo lulesh etj.) mbi njësi, sepse kjo mund të çojë në goditje elektrike ose rrezik për zjarr.



- Për të shmangur varfërimin e oksigjenit, sigurohuni që dhoma të keni ajrim të mjaftueshëm nëse së bashku me njësinë përdoret edhe ndonjë pajisje tjetër, si p.sh. vatër flake.
- Përpara pastrimit, sigurohuni të ndaloni përdorimin e njësisë, stakoni automatin ose hiqni kordonin elektrik. Në të kundërt mund të shkaktohet goditje elektrike dhe lëndim.
- Lidhëni njësinë vetëm në qarkun e specifikuar të ushqimit elektrik. Ushqimi elektrik i ndryshëm nga ushqimi i specifikuar mund të rezultojë në goditje elektrike, mbinxehje dhe zjarr.
- Rregullojeni tubin e kullimit në mënyrë të tillë që të garantoni kullimin e rregullt. Kullimi jo i mirë mund të shkaktojë lagështi në objekt, mobilie etj.
- Mos vendosni objekte shumë afër njësisë së jashtme dhe mos lejoni që gjethet ose papastërti të tjera të grumbullohen rreth njësisë. Gjethet janë një vend i mirë për kafshët e vogla që mund të futen brenda njësisë. Pasi futen brenda njësisë, këto kafshë të vogla mund të shkaktojnë defekte, tym ose zjarr kur bien në kontakt me pjesët elektrike.
- Mos vendosni objekte përreth njësisë së brendshme.
- Ky veprim mund të ketë ndikim negativ në performancën, cilësinë e produktit dhe jetëgjatësinë e njësisë.
- Fëmijët duhen mbajtur gjithmonë larg për të garantuar që ata të mos luajnë me pajisjen.

Vendi i instalimit.

- Konsultohuni me shitësin nëse dëshironi ta instaloni njësinë në llojet e mjediseve në vijim.**
 - Vende me mjedis me avuj vaji apo ku ka avull dhe blözë.
 - Mjedise me kripë, si p.sh. në zonat bregdetare.
 - Vendet ku ka prani të gazi sulfhidrik, si p.sh. në burime termale.
 - Vende ku dëbora mund të bllokojë njësinë e jashtme.
- Sigurohuni të ndiqni udhëzimet më poshtë.**
 - Njësia e brendshme duhet të jetë të paktën 1 m larg nga çdo pajisje radio ose televizor (njësia mund të shkaktojë interferencë te figura ose zëri).
 - Kullimi i njësisë së jashtme duhet të shkarkohet në një vend me drenim të mirë.

Bezdisja e fqinjëve nga zhurmat.

- Për instalimin, zgjidhni një vend siç tregohet më poshtë.**
 - Një vend mjaftueshëm i fortë për të mbajtur peshën e njësisë dhe që nuk përforcon zhurmën ose dridhjen e punës.
 - Një vend ku ajri që fryhet nga njësia e jashtme apo zhurma e punës nuk do të bezdisë fqinjët tuaj.

Punimet elektrike.


- Për ushqimin e elektrik, sigurohuni të përdorni një linjë elektrike të veçantë të dedikuar për njësinë.

Spostimi i sistemit.

- Spostimi i njësisë kërkon njohuri dhe aftësi të specializuara. Konsultohuni me shitësin nëse për shkak të zhvendosjes apo punimeve të rinovimit nevojitet spostimi i sistemit.

Emrat e pjesëve

Njësia e brendshme




Ekran

Marrësi i sinjalit

- Merr sinjalet nga pulti i komandimit.
- Kur njësia merr një sinjal, ju do të dëgjoni një tingull "bip".

Rasti	Lloji i tingullit
Nisja e përdorimit	bip-bip
Ndryshimi i cilësimeve	bip
Ndalimi i përdorimit	bip i gjatë



Çelësi i NDEZJES/FIKJES së njësies së brendshme


- Shtypni çelësin një herë për të nisur përdorimin. Shtypeni përsëri për ta ndaluar atë.
- Për cilësimin e regjimit të funksionimit, shihni tabelën më poshtë.

Regjimi	Cilësimi i temperaturës	Shpejtësia e qarkullimit të ajrit
AUTO	25°C	AUTO

- Çelësi mund të përdoret kur mungon pulti i komandimit.


Emrat e pjesëve

■ Hapni panelin ballor



Njësia e jashtme

- Pamja e njësisë së jashtme mund të jetë e ndryshme midis modeleve të ndryshme.



Emrat e pjesëve

Pulti i komandimit

Ekrani (LCD)

- Tregon cilësimet aktuale.
(Në këtë ilustrim, çdo seksion tregohet me pamjet e tij për qëllimin e shpjegimit.)

Butoni AUTO

- Zgjedh automatikisht një regjim të përshtatshëm funksionimi (FTOHJE ose NGROHJE) bazuar në temperaturën e brendshme dhe nis funksionimin. ► [Faqe 9](#)

Butonat direktë të funksionimit

- Nisin funksionin FTOHJE, THARJE, NGROHJE ose VETËM VENTILATOR. ► [Faqe 9](#)

Butoni i rregullimit të TEMPERATURËS

- Ndryshon cilësimin e temperaturës. ► [Faqe 10](#)

Butoni COMFORT

- Funksioni QARKULLIM AJRI KOMFORT. ► [Faqe 13](#)

Butoni POWERFUL

- Funksioni I FUQISHËM. ► [Faqe 13](#)


Butoni OFF TIMER (Regjimi CILËSIM PËR NATËN)

► [Faqe 16](#)

Butoni ON TIMER

► [Faqe 15](#)

Transmetuesi i sinjalit



- Për të përdorur pultin e komandimit/telekomandën, drejtoni transmetuesin në njësinë e brendshme. Nëse ka ndonjë objekt që bllokton sinjalet midis njësisë dhe pultit të komandimit, si p.sh. një perde, njësia mund të mos punojë.
- Distanca maksimale e transmetimit është rreth 7 m.

Butoni OFF

- Ndalon funksionimin e njësisë. ► [Faqe 10](#)

Butoni FAN

- Zgjedh cilësimin e shpejtësisë së fryrjes. ► [Faqe 11](#)

Butoni ECONO


- Funksioni EKONOMIK. ► [Faqe 14](#)

Butoni SWING




- Rregullon drejtimin e fryrjes së ajrit. ► [Faqe 12](#)

Butoni TIMER CANCEL

- Anulon cilësimin e kohëmatësit. ► [Faqe 15, 16](#)



Përgatitja përpara përdorimit



Futja e baterive

1. Hiqni kapakun e pasmë duke e rrëshqitur dhe duke e ngritur paksa lart.
2. Futni 2 bateri të thata AAA.LR03 (alkaline).
3. Vendosni kapakun.

Mbërthimi i mbajtëses së pultit në një mur

1. Zgjidhni një vend ku sinjalet arrijnë njësinë.
2. Montoni mbajtësen në mur apo vend të ngjashëm, duke përdorur vidat që jepen me mbajtësen.
3. Varni pultin e komandimit në mbajtësen e tij.

Këmbimi i afishimit Fahrenheit/Celsius

- Mbani shtypur njëkohësisht për rreth 5 sekonda butonin  dhe  (butonin TIMER).

- Temperatura do të tregohet në gradë Celsius kur ajo tregohet aktualisht në Fahrenheit, dhe anasjellas.
- Përdorimi i çelësit është i mundur vetëm kur tregohet temperatura.

Ndezja e automatit të qarkut

- Pasi rikthehet energjia, mbyllësja në njësinë e brendshme hapet dhe mbyllet një herë për të kaluar në pozicionin referencë.

SHËNIM

Shënime për bateritë

- Kur ndërroni bateritë, përdorni bateri të të njëjtit lloj dhe ndërroni njëherësh të dyja bateritë e vjetra.
- Bateritë zgjasin për rreth 1 vit. Megjithatë, nëse ekran i pultit të komandimit fillon të zbehet dhe rrezja e mundshme e transmetimit shkurtohet brenda një viti, ndërroni të dyja bateritë me bateri të reja të madhësisë AAA.LR03 (alkaline).
- Bateritë e ofruara me pultin e komandimit janë për përdorimin fillestar. Ato mund të konsumohen në më pak se 1 vit.

Shënim për pultin e komandimit

- Mos e lëshoni poshtë pultin e komandimit. Mos e lagni atë.



Përdorimi i AUTO · FTOHJE · THARJE · NGROHJE · VETËM VENTILATOR



Njësia punon në regjimin e punës që ju zgjidhni.

Nisja e përdorimit

Përdorimi i regjimit AUTO

- Për të zgjedhur automatikisht një temperaturë të përshtatshme dhe regjimin e punës.

● Shtypni butonin **AUTO**.



Përdorimi i regjimit FTOHJE

- Për të ulur temperaturën.

● Shtypni butonin **COOL**.



Përdorimi i regjimit THARJE

- Për të ulur nivelin e lagështisë.

● Shtypni butonin **DRY**.



Përdorimi i regjimit NGROHJE

- Për të rritur temperaturën.

● Shtypni butonin **HEAT**.




Përdorimi i regjimit VETËM VENTILATOR

- Për të qarkulluar ajrin në dhomë.

● Shtypni butonin **FAN ONLY**.



- Drita e FUNKSIONIMIT ndriçon në ngjyrë të gjelbër.



Ekrani

SHËNIM


Shënime për regjimin AUTO

- Në regjimin AUTO, sistemi zgjedh një mënyrë të përshtatshme funksionimi (ftohje ose ngrohje) bazuar në temperaturën e brendshme dhe nis funksionimin.
- Sistemi rrezjedh automatikisht cilësimin në një interval të rregullt për ta sjellë temperaturën e brendshme në një nivel sa më afër cilësimit nga përdoruesi.

Shënime për regjimin THARJE

- Eliminon lagështirën duke ruajtur temperaturën e brendshme sa më shumë të jetë e mundur. Ai kontrollon automatikisht temperaturën dhe shpejtësinë e qarkullimit të ajrit, kështu që përshtatja manuale e këtyre funksioneve nuk është e mundur.

Përdorimi i AUTO · FTOHJE · THARJE · NGROHJE · VETËM VENTILATOR



Ndalimi i përdorimit

▶ Shtypni butonin **OFF**.

- Llamba e FUNKSIONIMIT fiket.

Ndërrimi i cilësimit të temperaturës

▶ Shtypni butonin **TEMP**.

- Shtypni **▲** për ta rritur temperaturën dhe shtypni **▼** për ta ulur atë.

Përdorimi i regjimit FTOHJE	Përdorimi i regjimit NGROHJE	Përdorimi i regjimit AUTO	Funksioni THARJE ose VETËM VENTILATOR
18 – 32°C	10 – 30°C	18 – 30°C	Cilësimi i temperaturës nuk mund të ndryshohet.

Këshilla për kursimin e energjisë

Vendosja e cilësimit të temperaturës në një nivel mesatar ndihmon në kursimin e energjisë.

- Cilësimi i rekomanduar i temperaturës
 - Për ftohje: 26 – 28°C
 - Për ngrohje: 20 – 24°C

Mbuloni dritaret me një grilë ose me perde.

- Bllokimi i dritës së diellit dhe ajrit nga jashtë rrit efektin e ftohjes (ngrohjes).

Mbani pastër filtrat e ajrit.

- Filtrat e bllokuar të ajrit shkaktojnë funksionim joefikas dhe çojnë dëm energji. Pastrojini ato çdo 2 javë. **►Faqe 18**

Nëse nuk do ta përdorni kondicionerin për një periudhë të gjatë, p.sh. në pranverë ose vjeshtë, stakoni automat.

- Njësia harxhon gjithmonë një sasi të vogël energjie elektrike edhe nëse ajo nuk është duke punuar.






Përshtatja e shpejtësisë së fryrjes së ajrit

Ju mund të përshtatni shpejtësinë e fryrjes së ajrit për të rritur komoditetin tuaj.

Përshtatja e cilësimit të shpejtësisë së fryrjes së ajrit

Shtypni butonin .

- Çdo shtypje e butonit  ndryshon me radhë cilësimin e shpejtësisë së fryrjes së ajrit.



- Kur fryrja e ajrit caktohet te "  ", nis funksionimi i qetë dhe zhurma e njësisë së jashtme do të jetë edhe më e vogël.
- Në regjimin e funksionimit të qetë, shpejtësia e fryrjes së ajrit vendoset në një nivel të ulët.

Përdorimi i AUTO, FTOHJE, NGROHJE- dhe VETËM VENTILATOR				Përdorimi i regjimit THARJE
			...	
				Cilësimi i shpejtësisë së fryrjes së ajrit nuk mund të ndryshohet.

- Në regjimin NGROHJE, për të shmangur krijimin e rrymës së ajrit të ftohtë, shpejtësia e fryrjes së ajrit ulët. Kur temperatura e fryrjes së ajrit rritet, funksionimi do të vazhdojë në shpejtësinë e dëshiruar të fryrjes së ajrit.

SHËNIM

Shënim për cilësimin e shpejtësisë së fryrjes së ajrit

- Në shpejtësi të ulëta të fryrjes së ajrit, efekti i ftohjes (ngrohjes) është gjithashtu më i vogël.

Kur njësia arrin temperaturën e synuar:

- Ventilatori ndalon punën në regjimin e funksionimit FTOHJE / AUTO
- Ventilatori punën në shpejtësi "mesatare e ulët" në regjimin e funksionimit NGROHJE



Përshtatja e drejtimit të fryrjes së ajrit

Ju mund të përshtatni drejtimin e fryrjes së ajrit për të rritur komoditetin tuaj.



KUJDES


- Përdorni gjithmonë një pult komandimi për të përshtatur këndin e mbyllëses ballore. Lëvizja e mbyllëses manualisht me forcë mund të shkaktojë anomali.
- Bëni kujdes kur përshtatni grilat. Brenda vrimës së daljes së ajrit një ventilator rrotullohet me shpejtësi të lartë.

Nisja e lëkundjes automatike

Drejtimi i fryrjes lart e poshtë

● Shtypni butonin  .

- "  " shfaqet në ekranin LCD.
- Mbyllësja (fleta horizontale) fillon të lëkundet.



Vendosja e mbyllëses në pozicionin e dëshiruar

- Ky funksion është i vlefshëm kur mbyllësja ndodhet në regjimin e lëkundjes automatike.


● Shtypni butonin  kur mbyllësja arrin pozicionin që dëshironi.

- "  " zhduket nga ekrani LCD.

Përshtatja e grilave në pozicionin e dëshiruar

● Mbani rrotëzat dhe lëvizni grilat (fletët vertikale).

Midis 2 vendeve ndodhet një rrotëz.




SHËNIM

Shënim për cilësimin e drejtimit të fryrjes së ajrit

- Diapazoni i lëvizjes së mbyllëses ndryshon sipas regjimit të funksionimit.
- Mbyllësja do të ndalojë në pozicionin e sipërm kur shpejtësia e fryrjes së ajrit kalohet në shpejtësi në ulët, gjatë cilësimit të lëkundjes lart e poshtë.

Diapazoni i lëvizjes së mbyllëses





Përdorimi i funksionit QARKULLIM AJRI KOMFORT

Drejtimi dhe shpejtësia e fryrjes së ajrit përshtaten në mënyrë të tillë që të mos i fryjnë direkt njerëzve në dhomë.

Nisja e përdorimit të funksionit QARKULLIM AJRI KOMFORT

● Shtypni butonin .

- "  " shfaqet në ekranin LCD.

	Përdorimi i regjimit FTOHJE dhe THARJE	Përdorimi i regjimit NGROHJE
Drejtimi i mbyllëses	Shkon lart	Zbret poshtë
Shpejtësia e qarkullimit të ajrit	AUTO	

- Nuk disponohet për regjimin VETËM VENTILATOR.

Anulimi i përdorimit të funksionit QARKULLIM AJRI KOMFORT

● Shtypni përsëri butonin .

- "  " zhduket nga ekrani LCD.
- Mbyllësja do të kthehet në pozicionin e memorizuar përpara përdorimit të funksionit QARKULLIM AJRI KOMFORT.



Përdorimi i funksionit I FUQISHËM

Përdorimi i funksionit I FUQISHËM maksimizon shpejt efektin e ftohjes (ngrohjes) në çdo regjim funksionimi. Në këtë regjim, njësia punon me kapacitet maksimal.

Nisja e përdorimit të funksionit I FUQISHËM

● Shtypni butonin .

- "  " shfaqet në ekranin LCD.
- Funksioni I FUQISHËM përfundon për 20 minuta. Pas kësaj kohe, sistemi punon sërish automatikisht me cilësimet e mëparshme që janë përdorur përpara përdorimit të funksionit I FUQISHËM.


Anulimi i përdorimit të funksionit I FUQISHËM

● Shtypni përsëri butonin .

- "  " zhduket nga ekrani LCD.



Përdorimi i funksionit EKONOMIK



Funksioni EKONOMIK mundëson funksionimin efikas duke kufizuar konsumin maksimal të energjisë.

Ky funksion është i dobishëm për të parandaluar veprimin e automatit kur njësia përdoret bashkë me pajisje të tjera në të njëjtën linjë elektrike.

Nisja e përdorimit të funksionit EKONOMIK

● Shtypni butonin .

- " " shfaqet në ekranin LCD.
- Nuk disponohet për regjimin VETËM VENTILATOR.

Anulimi i përdorimit të funksionit EKONOMIK

● Shtypni përsëri butonin .

- " " zhduket nga ekrani LCD.

SHËNIM

Shënim për përdorimin e funksionit QARKULLIM AJRI KOMFORT

- Nëse zgjidhet drejtimi i fryrjes së ajrit lart e poshtë, funksioni QARKULLIM AJRI KOMFORT do të anulohet.

Shënime për funksionin I FUQISHËM

- Shtypja e butonit bën që cilësimet të anulohen dhe " " zhduket nga ekrani LCD.
- Funksioni "I FUQISHËM" nuk do ta rritë kapacitetin e njësisë nëse njësia është tashmë duke punuar me kapacitetin maksimal të treguar.

– Në regjimin FTOHJE, NGROHJE dhe AUTO

Për të rritur në maksimum efektin e ftohjes (ngrohjes) kapaciteti i njësisë së jashtme dhe shpejtësia e fryrjes së ajrit fiksohen në cilësimin maksimal.

Cilësimi i temperaturës nuk mund të ndryshohet.

– Në regjimin THARJE

Cilësimi i temperaturës ulet me 2,5°C dhe rritet paksa shpejtësia e fryrjes së ajrit.

– Në regjimin VETËM VENTILATOR

Shpejtësia e fryrjes së ajrit fiksohet në cilësimin maksimal.

Shënime për funksionin EKONOMIK

- Shtypja e butonit bën që cilësimet të anulohen dhe " " zhduket nga ekrani LCD.
- Nëse konsumi i energjisë është tashmë i ulët, kalimi në funksionin EKONOMIK nuk do të reduktojë konsumin e energjisë.


Disa funksione të dobishme mund të përdoren së bashku.

QARKULLIM AJRI KOMFORT + EKONOMIK	Disponohet
I FUQISHËM + QARKULLIM AJRI KOMFORT	Nuk disponohet*
I FUQISHËM + EKONOMIK	Nuk disponohet*

*Prioritet i jepet funksionit butoni i të cilit është shtypur i fundit.



Përdorimi i KOHËMATËSIT TË NDEZJES/FIKJES



Funksionet e kohëmatësit janë të dobishme për ndezjen ose fikjen automatike të njësisë natën ose në mëngjes. Gjithashtu mund të përdorni bashkërisht edhe KOHËMATËSIN E NDEZJES dhe KOHËMATËSIN E FIKJES.


Përdorimi i KOHËMATËSIT TË NDEZJES

● Shtypni butonin **ON** .



" ON " shfaqet në ekranin LCD.

- Çdo shtypje e butonit **ON** e shtyn përpara cilësimin e kohës me nga një 1 orë. Koha mund të vendoset midis 1 dhe 12 orëve.
- Llamba e KOHËMATËSIT ndriçon në ngjyrë portokalli.



Ekranin

Përdorimi i KOHËMATËSIT TË NDEZJES

● Shtypni butonin **CANCEL** .

- " ON " zhduket nga ekranin LCD.
- Llamba e KOHËMATËSIT fiket.

SHËNIM

Vendosni përsëri kohëmatësin në rastet e mëposhtme.

- Pasi është fikur automati.
- Pasi ka ndodhur shkëputje e energjisë.
- Pasi janë ndërruar bateritë e telekomandës.

Përdorimi i KOHËMATËSIT TË NDEZJES/FIKJES


Përdorimi i KOHËMATËSIT TË FIKJES

► Shtypni butonin **OFF** .



" OFF 1 HR. " shfaqet në ekranin LCD.

- Çdo shtypje e butonit **OFF** e shtyn përpara cilësimin e kohës me nga një 1 orë. Koha mund të vendoset midis 1 dhe 12 orëve.
- Llamba e KOHËMATËSIT ndriçon në ngjyrë portokalli.



Ekran

Anulimi i KOHËMATËSIT TË FIKJES

► Shtypni butonin **CANCEL** .

- " OFF 1 HR. " zhduket nga ekranin LCD.
- Llamba e KOHËMATËSIT fiket.

Kombinimi i përdorimit të KOHËMATËSIT TË NDEZJES dhe FIKJES


- Një cilësim shembull për kombinimin e 2 kohëmatësve tregohet më poshtë.
- " ON " dhe " OFF " shfaqen në ekranin LCD.

[Shembull]



Kur vendoset ndërsa njësia është duke punuar

- Fik njësinë 1 orë më vonë dhe e ndez përsëri atë 7 orë pas fikjes.



Kur vendoset ndërsa njësia është e ndaluar

- Ndez njësinë 2 orë më vonë dhe e fik përsëri atë 3 orë pas ndezjes.

SHËNIM

Regjimi CILËSIM PËR NATËN

- Kur është vendosur KOHËMATËSI I FIKJES, njësia përshtat automatikisht cilësimin e temperaturës (ritje 0,5°C në FTOHJE, ulje 2,0°C në NGROHJE) për të parandaluar ftohjen (ngrohjen) e tepërt gjatë orëve të gjumit.

Kujdesi dhe pastrimi

⚠ KUJDES

- Përpara pastrimit, sigurohuni të ndaloni përdorimin e njësishë dhe stakoni automatën.
- Mos i prekni fletët e aluminit në njësine e brendshme. Nëse i prekni këto pjesë, ky veprim mund të shkaktojë lëndim.

■ Udhëzuesi i shpejtë

Pastrimi i pjesëve

Paneli ballor

- Fshijeni me një leckë të lagësht të butë.
- Mund të përdoret vetëm detergjent neutral.

Nëse është pis



Filtri i ajrit

- Hiqni pluhurin me fshesë me vakuum ose lani filtrin.

Një herë në çdo 2 javë

► Faqe 18

Njësia e brendshme, njësia e jashtme dhe pultit i komandimit

- Fshijini me një leckë të butë.

Nëse është pis

Filtri aromatizues me apatit titani (pa skelet)

- Hiqni pluhurin me fshesë me vakuum ose zëvendësoni filtrin.

[Pastrim]

Një herë në çdo 6 muaj

► Faqe 19

[Zëvendësim]

Një herë në çdo 3 vjet

► Faqe 19

SHËNIM

Për pastrimin mos përdorni asnjë nga sa më poshtë:

- Ujë më të nxehtë se 40°C
- Lëngje të avullueshme, si p.sh. benzen, benzinë dhe hollues
- Komponente për lustrim
- Materiale të ashpra, si p.sh. furçë gërryerjeje




Kujdesi dhe pastrimi

■ Filtri i ajrit


1. Hapni panelin ballor.

- Kapeni panelin ballor nga anët dhe hapeni atë.




2. Nxirrni jashtë filtrat e ajrit.

- Shtyni paksa lart gjuhëzën e filtrit në qendër të çdo filtri ajri dhe pastaj tërhiqeni poshtë.



3. Lani filtrat e ajrit me ujë ose pastrojini me fshesë me vakuum.

- Rekomandohet që filtrat e ajrit të pastrohen çdo 2 javë.



Nëse pluhuri nuk fshihet lehtë


- Lani filtrat e ajrit me detergjent neutral të holluar me ujë të vakët dhe më pas thajini në një hije.



4. Vendosni sërish në vend filtrat.

5. Mbyllni me ngadalë panelin ballor.

- Shtyjeni panelin ballor nga të dyja anët dhe në qendër.



- Sigurohuni që paneli ballor është mbërthyer mirë.

Kujdesi dhe pastrimi


■ Filtri aromatizues me apatit titani

1. Hapni panelin ballor dhe nxirrni jashtë filtrat e ajrit.

► Faqe 18

2. Hiqni filtrat aromatizues me apatit titani.

- Shkëputni filtrat nga mbajtëset.



3. Pastroni ose zëvendësoni filtrat aromatizues me apatit titani.

[Pastrim]

- 3-1 Fshini pluhurin me fshesë me vakuum dhe zhyteni në ujë të vakët ose ujë normal për rreth 10 deri në 15 minuta, nëse është shumë pis.




- 3-2 Pas larjes, shkundeni ujin e mbetur dhe lëreni të thahet në hije.

- Mos e shtrydhni filtrin për të larguar ujin prej tij.

[Zëvendësim]

Hiqni filtrin nga mbajtëset dhe përgatitni një filtër të ri.



- Hidhni filtrin e vjetër si mbetje jo e ndezshme.

4. Futni filtrat aromatizues me apatit titani siç ishin.

- Kur montoni filtrin sigurohuni që filtri të futet si duhet në mbajtëset e tij.

5. Vendosni sërish në vend filtrat. ► Faqe 18

6. Mbyllni me ngadalë panelin ballor. ► Faqe 18

SHËNIM

- Përdorimi me filtra të ndotur:
 - nuk mund të aromatizojë ajrin,
 - nuk mund të pastrojë ajrin,
 - rezultoni në ngrohje ose ftohje të dobët,
 - mund të shkaktojë aromë të pakëndshme.
- Hidhni filtrat e vjetër si mbetje jo të ndezshme.
- Për të porositur një filtër aromatizues me apatit titani kontaktoni me shitësin ku keni blerë njësinë.

Artikulli	Filtër aromatizues me apatit titani 1 set
Nr. i pjesës	KAF970A46

Kujdesi dhe pastrimi

■ Përpara një periudhe të gjatë mospërdorimi

1. Përdorni regjimin VETËM VENTILATOR për disa orë për të tharë pjesën e brendshme.

- Shtypni butonin **FAN ONLY**.

2. Pasi funksioni të ndalojë, stakoni automatin e njësisë së dhomës.


3. Hiqni bateritë nga telekomanda.

■ Ne rekomandojmë mirëmbajtje periodike

- Në kushte të caktuara pune, pjesa e brendshme e njësisë mund të bllokohet pas disa sezonesh përdorimi, duke çuar në performancë të dobët. Rekomandohet që të kryeni një mirëmbajtje periodike nga një kontraktor i kualifikuar, përveç kujdesit të pastrimit nga vetë përdoruesi.
- Për mirëmbajtje të kualifikuar nga kontraktori kontaktoni me shitësin ku keni blerë njësinë.

■ Sezoni dimëror

Copat e akullit duhet të hiqen. Përdorni doreza për të evituar lëndimin dhe dëmtimin e njësisë.



Informacion i rëndësishëm lidhur me gazin ftohës të përdorur

Ky produkt përmban gaze serrë të fluorinuara. Mos i shkarkoni gazet në atmosferë.

Lloji i gazit ftohës: **R32**

Vlera GWP ⁽¹⁾: **675**

⁽¹⁾ GWP = Potenciali i ngrohjes globale

Sipas legjislacionit evropian ose lokal, mund të kërkohen inspektime periodike për rrjedhje të gazit ftohës. Kontaktoni me shitësin lokal për më shumë informacion.



NJOFTIM lidhur me tCO₂eq

Në Evropë, **shkarkimet e gazeve serrë** të sasisë totale të gazit ftohës në sistem (të shprehura si tonë të CO₂-ekuivalent) përdoren për të përcaktuar intervalet e mirëmbajtjes. Respektoni legjislacionin e zbatueshëm.

Formula për të llogaritur shkarkimet e gazeve serrë:

Vlera GWP e gazit ftohës × Sasia totale e gazit ftohës [në kg] / 1000

FAQ

- Rastet e mëposhtme nuk janë defekte të njësive, por kanë një shkak. Ju mund të vazhdoni me përdorimin e tij.

Njësia e brendshme

Mbyllësja nuk fillon të lëkundet menjëherë.

- Njësia po rregullon pozicionin e mbyllësës. Mbyllësja do të fillojë të lëvizë së shpejti.

Njësia ndalon krijimin e qarkullimit të ajrit gjatë punës.

- Kur arrihet temperatura e vendosur, shpejtësia e fryrjes së ajrit reduktohet dhe funksionimi ndalet për të shmangur krijimin e një rryme ajri të ftohtë (në regjimin e ngrohjes) ose për të parandaluar rritjen e lagështisë (në regjimin e ftohjes). Puna do të rifillojë automatikisht kur temperatura e brendshme rritet ose bie.

Funksionimi i regjimit NGROHJE ndalon menjëherë dhe dëgjohet një tingull shfryrjeje.

- Njësia e jashtme është duke shkrië. Funksionimi i regjimit NGROHJE nis pasi të jetë larguar akulli nga njësia e jashtme. Kjo mund të zgjasë 4 deri në 12 minuta.


Funksionimi nuk fillon së shpejti.

- Kur **AUTO** ose ndonjë buton direkt i funksionimit është shtypur menjëherë pasi ka ndaluar puna.
- Kur është rizgjedhur regjimi i punës.
 - Kjo është për të mbrojtur njësine.
 - Duhet të prisni për rreth 3 minuta.

Njësia e jashtme


Njësia e jashtme lëshon ujë ose avull.

- Në regjimin NGROHJE
 - Akulli në njësine e jashtme shkrihet në ujë ose avull kur njësia është në regjimin e shkriës.
- Në regjimin FTOHJE ose THARJE
 - Lagështia në ajër kondensohet në ujë në sipërfaqen e ftohtë të tubave të njësive së jashtme dhe pikon.



Dëgjohen tinguj të ndryshëm.

- **Një zhurmë si ujë që rrjedh**
 - Kjo zhurmë krijohet sepse gazi ftohës qarkullon nëpër njësi.
 - Kjo zhurmë krijohet kur uji largohet nga njësia gjatë funksioni FTOHJE ose THARJE.
- **Zhurmë fryrjeje**
 - Kjo zhurmë krijohet kur kryhet shkëmbimi i qarkullimit të gazit ftohës në njësi.
- **Zhurmë kërcitjeje**
 - Kjo zhurmë krijohet kur kabineti dhe korniza e njësive bymehet ose tkurret paksa si rezultat i ndryshimeve të temperaturave.
- **Tingull fishkëllime**
 - Kjo zhurmë krijohet kur gazi ftohës qarkullon gjatë operacionit të shkriës.
- **Tingull klikimi gjatë punës ose kohës së ndalimit**
 - Ky tingull krijohet kur punojnë valvulat e kontrollit të gazit ftohës ose pjesët elektrike.
- **Tingull trokitjeje**
 - Kjo zhurmë dëgjohet nga brenda njësive kur pajisja e jashtme thith ajrin për ta nxjerrë jashtë dhomës (p.sh. ventilator i nxjerrjes së ajrit, aspirator kuzhine), ndërkohë që dyert dhe dritaret në dhomë janë mbyllur. Hapni dyert ose dritaren ose fikni pajisjen.



Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve

Përpara se të bëni një pyetje apo të kërkonti një riparim, jeni të lutur të verifikoni sa më poshtë. Nëse problemi vazhdon, kontaktoni me shitësin.



Nuk është problem

Ky rast nuk tregon një problem.



Kontrollo

Kontrolloni dhe verifikoni përsëri përpara se të kërkonti riparime.

Njësia nuk punon

Rasti	Përshkrimi / çfarë të kontrolloni
Llamba e FUNKSIONIMIT është e fikur.	- A ka vepruar automati apo a është djegur siguresa? - A ka shkëputje të energjisë? - A janë vendosur baterinë në telekomandë?
Llamba e FUNKSIONIMIT pulson.	Shkëputni energjinë me anë të automatit dhe rinisni përdorimin me anë të telekomandës. Nëse llamba e FUNKSIONIMIT vazhdon të pulsojë përsëri, kontrolloni kodin e gabimit dhe kontaktoni me shitësin. ► Faqe 25

Njësia ndalon punën menjëherë

Rasti	Përshkrimi / çfarë të kontrolloni
Llamba e FUNKSIONIMIT është e ndezur.	Për të mbrojtur sistemin, njësia mund të ndalojë punën pas luhatjeve të mëdha e të menjëhershme të tensionit. Ai e rifillon punën automatikisht pas rreth 3 minutash.
Llamba e FUNKSIONIMIT pulson.	- A ka ndonjë objekt që pengon vrimën e hyrjes apo të daljes së ajrit në njësine e brendshme ose të jashtme? - Ndaloni funksionimin e kondicionerit dhe pasi të keni fikur automatën, hiqni pengesën. Pastaj rindizeni me anë të telekomandës. Nëse llamba e FUNKSIONIMIT vazhdon të pulsojë përsëri, kontrolloni kodin e gabimit dhe kontaktoni me shitësin. ► Faqe 25

Njësia nuk e ndalon punën

Rasti	Përshkrimi / çfarë të kontrolloni
Njësia vazhdon të punojë edhe pasi të jetë ndaluar funksionimi i saj.	■ Menjëherë pas ndalimit të njësise - Ventilatori i njësise së jashtme vazhdon të rrotullohet edhe për rreth 1 minutë për të mbrojtur sistemin. ■ Kur njësia nuk është në punë - Kur temperatura e jashtme është e lartë, ventilatori i njësise së jashtme mund të nisë të rrotullohet për të mbrojtur sistemin.

Dhoma nuk ftohet / nuk ngrohet

Rasti	Përshkrimi / çfarë të kontrolloni
Nuk del ajër nga kondicioneri.	■ Në regjimin NGROHJE - Njësia është duke u ngrohur. Pritni për rreth 1 deri në 4 minuta. - Gjatë operacionit të shkrirjes, njësia e brendshme nuk nxjerr ajër të nxehtë.
Nuk del ajër / Del ajër.	■ A është i përshtatshëm cilësimi i shpejtësisë së fryrjes së ajrit? - A është cilësimi i shpejtësisë së fryrjes së ajrit i ulët, si p.sh. "Njësi e brendshme e qetë" apo "Shpejtësi e fryrjes së ajrit 1"? Rritni cilësimin e shpejtësisë së fryrjes së ajrit. ■ A është e përshtatshme temperatura e vendosur? ■ A është i përshtatshëm rregullimi i drejtimit të fryrjes së ajrit?
Del ajër.	- A ka ndonjë mobilie direkt poshtë apo anash njësise së brendshme? - A është njësia duke punuar në funksionin "EKONOMIK"? ► Faqe 14 - A janë të ndotur filtrat e ajrit? - A ka ndonjë objekt që pengon vrimën e hyrjes apo të daljes së ajrit në njësine e brendshme ose të jashtme? - A ka ndonjë dritare ose derë të hapur? - A ka ndonjë ventilator duke punuar?

Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve

Jashtë del avull

Rasti	Përshkrimi / çfarë të kontrolloni
Nga njësia e brendshme del jashtë avull.	☒ • Kjo ndodh kur ajri në dhomë është fthhur në mjegull nga ajri i fthhtë i qarkulluar gjatë regjimit FTOHJE ose ndonjë regjim tjetër.

Pulti i komandimit

Rasti	Përshkrimi / çfarë të kontrolloni
Njësia nuk merr sinjalet nga telekomanda ose ka rreze të kufizuar veprimi.	☒ • Mund të jenë shkarkuar bateritë. Ndërroni të dyja bateritë me bateri të reja të thata AAA.LR03 (alkaline). Për detaje shihni seksionin "Përgatitja përpara përdorimit". ► Faqe 8 ☒ • Komunikimi i sinjalit mund të çaktivizohet nëse një llambë fluoeshente e llojit me starter elektronik (p.sh. llambat e llojit inverter) ndodhet në dhomë. Konsultohuni me shitësin nëse është ky rast. ☒ • Telekomanda mund të mos funksionojë si duhet nëse transmetuesi është ekspozuar në dritën e diellit.
Ekrani LCD është i zbehtë, nuk punon ose afishimi ka gabime.	☒ • Mund të jenë shkarkuar bateritë. Ndërroni të dyja bateritë me bateri të reja të thata AAA.LR03 (alkaline). Për detaje shihni seksionin "Përgatitja përpara përdorimit". ► Faqe 8
Niset përdorimi i pajisjeve të tjera elektrike.	☒ • Nëse telekomanda aktivizon pajisje të tjera elektrike, hiqini këto pajisje ose konsultohuni me shitësin.

Ajri që del ka një aromë

Rasti	Përshkrimi / çfarë të kontrolloni
Njësia lëshon një aromë.	☒ • Aroma e dhomës e thithur në njësi shkarkohet me ajrin që fryn. Ne rekomandojmë që të pastroni njësinë e brendshme. Konsultohuni me shitësin tuaj.

Të tjera

Rasti	Përshkrimi / çfarë të kontrolloni
Njësia fillon papritur të sillet në mënyrë të çuditshme gjatë punës.	☐ • Njësia mund të ketë ndonjë keqfunksionim për shkak të një rufeje apo valëve radio. Nëse njësia shfaq ndonjë keqfunksionim, shkëputni energjinë me anë të automatit dhe rinisni përdorimin me anë të telekomandës.

Shënime për kushtet e përdorimit

- Nëse përdorimi vazhdohet në rrethana të ndryshme nga ato të renditura në tabelë,
 - Një pajisje sigurie mund të aktivizojë ndalimin e funksionimit.
 - Në njësinë e brendshme mund të formohet djersitje dhe ajo të pikoje kur zgjidhet regjimi FTOHJE ose THARJE.

Regjimi	Kushtet e funksionimit
FTOHJE / THARJE	Temperatura e jashtme: -10~46°C Temperatura e brendshme: 18~32°C Lagështia e brendshme: 80% maks.
NGROHJE	Temperatura e jashtme: -25~24°C Temperatura e brendshme: 10~30°C

Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve

■ Telefononi menjëherë qendrën e servisit

PARALAJMËRIM

Kur ndodh diçka jonormale (p.sh. aromë djegieje), ndaloni përdorimin dhe stakoni automatën elektrik.

- Vazhdimi i përdorimit në një rrethanë jonormale mund të shkaktojë probleme, goditje elektrike ose zjarr.
- Kontakti me qendrën e servisit ku keni blerë njësinë.

Mos u përpuni që ta riparoni apo modifikoni vetë njësinë.

- Puna e pasaktë mund të shkaktojë goditje elektrike ose zjarr.
- Kontakti me qendrën e servisit ku keni blerë njësinë.

Nëse ndodh një nga simptomat e mëposhtme telefononi menjëherë qendrën e servisit.

- Kordoni elektrik është nxehtuar tejet ose është dëmtuar jo normalisht.
- Gjatë punës dëgjohet një zhurmë jo normale.
- Automati, siguresa ose automati mbrojtës i rrjedhjes së tokëzimit e ndërpret shpesh funksionimin.
- Një çelës ose buton shpesh nuk punon siç duhet.
- Ka një aromë djegieje.
- Nga njësia e brendshme rrjedh ujë.

Stakoni automatën dhe telefononi qendrën e servisit.



■ Pasi ka ndodhur shpëputje e energjisë

- Njësia e rifillon punën automatikisht pas rreth 3 minutash. Thjesht ju duhet të prisni për pak kohë.

■ Rrufeja

- Nëse rrufetë mund të godasin zonën përreth, ndaloni përdorimin dhe stakoni automatën për të mbrojtur sistemin.

■ Kërkesat për asgjësimin



Produkti juaj dhe bateritë e ofruara me telekomandën janë të shënuara me këtë simbol. Ky simbol nënkupton që produktet elektrike dhe elektronike dhe bateritë nuk duhet të përzihen me mbetjet e tjera të shtëpisë. Për bateritë, poshtë simbolit mund të jetë i printuar një simbol kimik. Ky simbol kimik tregon se bateria përmban një metal të rëndë përtej një përqendrimi të caktuar. Simbolet kimike të mundshme janë:

■ Pb: plumb (>0,004%)


Mos tentoni ta zbrëtheni vetë sistemin: zbrëthimi i produktit, trajtimi i gazit ftohës, i vajit dhe i pjesëve të tjera duhet të kryhet nga një instalues i kualifikuar, në përputhje me legjislacionin përkatës vendor dhe kombëtar.

Njësitë dhe bateritë e përdorura duhet të trajtohen në një objekt trajtimi të specializuar për ripërdorimin, riciklimin dhe rikuperimin nga mbetjet.

Duke siguruar asgjësimin e duhur, ju ndihmoni në parandalimin e pasojave të mundshme negative në mjedis dhe për shëndetin e njeriut.

Kontakti me instaluesin ose autoritetet lokale për më shumë informacion. Zbrëthimi i njësive, trajtimi i gazit ftohës, i vajit dhe i pjesëve të tjera duhet të kryhet në përputhje me rregulloret përkatëse vendore dhe kombëtare.

Lokalizimi dhe zgjidhja e problemeve



■ Diagnostikimi i defekteve nga telekomanda

- Telekomanda mund të marrë kodet përkatëse të gabimeve nga njësia e brendshme.

1. Kur **CANCEL** mbahet shtypur për rreth 5 sekonda, "00" pulson në pjesën e afishimit të temperaturës.

2. Shtypni disa herë **CANCEL** derisa të krijohet një tingull bip i vazhdueshëm.

- Tregimi i kodit ndryshon siç tregohet më poshtë dhe ju njofton me një sinjal bip të gjatë.

	KODI	KUPTIMI
SISTEMI	00	NORMAL
	UA	GABIM I KOMBINIMIT TË NJËSISË SË BRENDSHME-TË JASHTME
	U0	HUMBJE E GAZIT FTOHËS
	U2	RËNIE E TENSIONIT OSE MBITENSION I QARKUT KRYESOR
	U4	PROBLEM I KOMUNIKIMIT (MIDIS NJËSISË SË BRENDSHME DHE TË JASHTME)
NJËSIA E BRENDSHME	A1	DEFEKT I PCB-së BRENDIA
	A5	KONTROLLI I PRESIONIT TË LARTË OSE MBROJTËSI NDAJ NGRIRJES
	A6	DEFEKT MOTORI I VENTILATORIT
	C4	SENSOR ME DEFEKT I TEMPERATURËS SË SHKËMBYESIT TË NXEHTËSISË
	C9	SENSOR ME DEFEKT I TEMPERATURËS SË AJRIT TË THITHJES
NJËSIA E JASHTME	EA	GABIM I SHKËMBIMIT FTOHJE-NGROHJE
	E1	DEFEKT I PLLAKËS SË QARKUT
	E5	KA NISUR OL
	E6	NDEZJE ME DEFEKT E KOMPRESORIT
	E7	DEFEKT MOTORI DC I VENTILATORIT
	E8	MBIRRYMË NË HYRJE
	F3	KONTROLLI I TEMPERATURËS SË LARTË I TUBIT TË SHKARKIMIT
	F6	KONTROLLI I PRESIONIT TË LARTË (NË FTOHJE)
	F8	GABIM TEMPERATURA E BRENDSHME E KOMPRESORIT
	H0	DEFEKT I SENSORIT
	H6	NDALI I PUNËS PËR SHKAK TË SENSORIT ME DEFEKT TË ZBULIMIT TË POZICIONIT
	H8	DEFEKT I SENSORIT TË RRYMËS DC
	H9	SENSOR ME DEFEKT I TEMPERATURËS SË AJRIT TË THITHJES
	J3	SENSOR ME DEFEKT I TEMPERATURËS SË TUBIT TË SHKARKIMIT
	J6	SENSOR ME DEFEKT I TEMPERATURËS SË SHKËMBYESIT TË NXEHTËSISË
	L3	DEFEKT NGA NXEHTËSIA E PJESËVE ELEKTRIKE
	L4	TEMPERATURË E LARTË NË PLLAKËN FTOHËSE TË QARKUT TË INVERTERIT
	L5	MBIRRYMË NË DALJE
	P4	DEFEKT SENSORI I TEMPERATURËS SË PLLAKËS FTOHËSE TË QARKUT TË INVERTERIT

SHËNIM

- Një tingull bip i shkurtër tregon se kodet nuk korrespondojnë.
- Për të anuluar afishimin e kodeve, mbani shtypur **CANCEL** për rreth 5 sekonda. Afishimi i kodeve zhduket gjithashtu edhe kur nuk shtypet asnjë buton për 1 minutë.



DAIKIN INDUSTRIES CZECH REPUBLIC s.r.o.

U Nové Hospody 1/1155, 301 00 Plzeň Skvrňany, Czech Republic

DAIKIN EUROPE N.V.

Zandvoordestraat 300, B-8400 Oostende, Belgium

